



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 511 Akti

Nr. 397 Vendimi
Tiranë, më 9.6.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Suela Zhegu	Relatore
Alma Faskaj	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 8.6.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Besmir Stroka**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Pika 5, e nenit 179/ b, të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Besmir Stroka, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.6.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 21.6.2020 u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues komisionere Etleda Çiftja. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Steven Kessler.

3. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

5. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

6. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016,

¹Raport dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 28.2.2018.

si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar², duke konkluduar mbi “*përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Besmir Stroka*”.

7. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.

8. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

9. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 2.6.2021, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Besmir Stroka, dhe njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

10. Për një proces të rregullt ligjor, z. Besmir Stroka, i janë garantuar të drejtat: (i) për t’u njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; (ii) për t’u njohur me përbërjen e trupit gjykues; si dhe (iii) për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës/shpjegimet mbi rezultatet e hetimit. Në datën 1.6.2021 për sa rezultoi nga hetimi administrativ i procesit të rivlerësimit, subjektit iu dhanë 7 ditë kohë për t’u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj.

11. Z. Besmir Stroka, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat e tij në datën 4.6.2021. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me rezultatet e hetimit, deklaroi se është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

12. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht në datën 2.6.2021.

13. Seanca dëgjimore u zhvilluan në datën 8.6.2021, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Stiven Kessler.

14. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, si dhe shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

²Raporti i DSIK-së, i deklasifikuar me vendimin nr. ***, datë 26.5.2021, të KDZH-së.

³Raporti me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2021, i KLGJ-së.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

15. Subjekti i rivlerësimit, z. Besmir Stroka, ka qenë bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, si dhe ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit z. Besmir Stroka, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

16. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

17. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

18. Sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

19. Ndërsa, sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkrese/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private;
- e) raportin e kontrollit të figurës së dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- f) raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGj-ja;
- g) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- h) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

22. Bazuar në nenin 179/b, në nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Besmir Stroka, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, u krye mbi bazën e tri kritereve: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

A. VLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

Subjekti i rivlerësimit, z. Besmir Stroka, është bërë subjekt deklarues në vitin 2014 (pasi është emëruar për të kryer stazhin profesional më 31.10.2014) dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, ka dorëzuar deklaratat e interesave private për periudhën 2014 – 2016, si dhe deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar për efekt të ligjit nr. 84/2016 (siç quhet ndryshe edhe deklarata *Vetting*).

Komisioni, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore; (ii) burimet e krijimit të kësaj pasurie; (iii) të ardhurat; (iv) shpenzimet; si dhe (v) mundësinë për fshehje të pasurisë dhe deklarim të rremë apo konflikt interesit.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Në deklaratën e pasurisë *Vetting* (shtojca nr. 2) të datës 25.1.2017, subjekti i rivlerësimit Besmir Stroka ka deklaruar pasuritë, si vijon:

1. Automjet tip “D.C”, blerë në vitin 2014, viti i prodhimit 2006

Vlera e deklaruar:	14.000 euro
Zotërimi:	100%
Burimi i krijimit:	dhuratë nga familja
Në DPV-në e vitit 2014:	dhuratë nga familja
Mënyra e fitimit:	me kontratë shitblerje automjeti nr. ***, datë 16.9.2014.

1.1 Faktet e rezultuara nga hetimi i Komisionit

DPSHTRR-ja⁴ ka konfirmuar se subjekti Besmir Stroka ka të regjistruar në pronësinë e tij automjetin me targa AA *** KM. Referuar dosjes së automjetit, evidentohet se është blerë në vlerën 14.000 euro me kontratën e shitblerjes nr.****, datë 16.9.2014, të nënshkruar ndërmjet shitësit M. Ç dhe blerësit Besmir Stroka.

Ministria e Drejtësisë, Zyra e Regjistrimit Noterial⁵ ka informuar mbi aktin noterial të blerjes së automjetit, me kontratën e shitjes datë 16.9.2014, nga shtetasi Besmir Stroka.

1.2 Burimi i krijimit

Komisioni shtriu hetimin mbi personat e lidhur familjarë në lidhje me burimin e krijimit, pasi subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting*, si dhe në DPV-në e vitit 2014, si burim për blerjen e pasurisë automjet: “*Dhuratë nga familja*”.

Komisioni, bazuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, i kërkoi subjektit dokumentacion provues mbi të ardhurat e ligjshme të prindërve deri në momentin e blerjes së automjetit më

⁴Me shkresën nr. *** prot., datë 19.3.2021.

⁵Me shkresën nr. *** prot., datë 23.3.2021.

16.9.2014. Subjekti⁶, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “... *automjeti tip ‘D.C’ është blerë përpara fillimit të detyrës si gjyqtar, me kursimet e përbashkëta të familjes*”.

Për sa i përket të ardhurave të prindërve dhe mundësisë së tyre financiare për blerjen e automjetit, subjekti ka shpjeguar dhe dokumentuar të ardhurat e përfituara nga veprimtaria tregtare e babait të tij, z. H.S, në fushën e sigurimit të objekteve publike dhe private, mbrojtjes së jetës dhe shëndetit (polici private) të regjistruar në organet tatimore, nga ku ka rezultuar zotërues i 50 % të kuotave të shoqërisë “P-g” sh.p.k., me NIPT K***P (për periudhën 2003 – 2010), si drejtues teknik i punësuar pranë kësaj shoqërie, të ardhurat e përfituara nga pensioni suplementar nga data 7.11.2004 e në vijim, gjithashtu edhe të ardhurat e krijuara nga veprimtaria tregtare pranë shoqërisë “S” sh.p.k., e themeluar në vitin 2010 me NIPT L***G, si administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë.

Gjithashtu, subjekti ka dokumentuar të ardhurat e realizuara nga nëna e tij, zj. A.S, si e punësuar pranë OSHEE-së për një periudhë 30-vjeçare, të ardhurat e realizuara nga motra e subjektit, znj. E.S, si e punësuar pranë shoqërisë “S” sh.p.k., për periudhën tetor 2012 – prill 2015, si dhe të ardhurat e realizuara gjatë punësimit të tij pranë shoqërisë “S” sh.p.k. për periudhën janar 2010 – tetor 2014 dhe të gjitha të ardhurat e përfituara janë të dokumentuara përmes sistemit bankar⁷.

ISSH-ja⁸ ka dërguar të dhënat mbi të ardhurat financiare *bruto* dhe *neto* të realizuara nga subjekti i rivlerësimit dhe familjarë të tij.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve⁹ ka informuar se subjekti Besmir Stroka nuk rezulton të ketë apo të ketë pasur aktivitet ekonomik të regjistruar në emër të tij, ndërsa babai i subjektit, z.H.S, rezulton i regjistruar në organin tatimor duke ushtruar aktivitet ekonomik si administrator dhe aksioner i shoqërisë “S” sh.p.k., me 100% të kuotave, i regjistruar si tatimpagues në datën 18.1.2010. Bashkëlidhur shkresës janë dërguar të dhënat mbi detyrimet tatimore të biznesit, si dhe ekstrakti i pagesave për sigurimet/tatimi mbi të ardhurat personale për subjektin dhe familjarë të tij.

Subjekti ka dokumentuar të ardhurat e familjarëve, të cilat kanë shërbyer si burim për blerjen e automjetit dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Kushtetutës.

1.3 Analiza financiare

⁶Në përgjigje të pyetësorit datë 10.5.2021, protokolluar me nr. *** prot., datë 14.5.2021.

⁷Subjekti ka depozituar dokumentacionin justifikues: shkresa nr. *** prot., datë 14.5.2021, të Drejtorisë Rajonale Tiranë, përmes së cilës është vënë në dispozicion dokumentacioni për shoqërinë tregtare “P-g” sh.p.k., lidhur me të ardhurat e realizuara nga shoqëria për periudhën 2003-2010; shkresa nr. *** prot., datë 14.5.2021, të Drejtorisë Rajonale Tiranë, përmes së cilës është vënë në dispozicion dokumentacioni për shoqërinë tregtare “S” sh.p.k., lidhur me të ardhurat e realizuara nga shoqëria për periudhën 2010-2014; pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve për shoqërinë “S” sh.p.k. për periudhën 2011-2018; lëvizjet e llogarisë bankare pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, të znj. E. S, ku i ka kaluar paga nga shoqëria “S” sh.p.k. për periudhën 1.11.2012 - 31.3.2017; vërtetim për bazën e vlerësueshme nga shoqëria “S” sh.p.k. për znj. E.S; vërtetim për bazën e vlerësueshme nga shoqëria “S” sh.p.k. për z. H.S; lëvizjet e llogarisë bankare pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, të z. H.S, ku i ka kaluar paga nga shoqëria “P-g” sh.p.k. dhe shoqëria “S” sh.p.k., si dhe ku ka depozituar kursimet e siguruara ndër vite; lëvizjet e llogarisë bankare pranë “Intesa Sanpaolo Bank” të z. H.S nga llogaria ku ka pasur kursimet familjare ndër vite; vërtetim nr. *** prot., datë 12.5.2021, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë; vërtetim nr. *** prot., datë 12.5.2021, i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë për z. H.S; vërtetim nr. *** prot., datë 12.5.2021, i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për z. Besmir Stroka; vërtetim nr.*** prot., datë 12.5.2021, i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë për znj. E.S; vërtetim për bazën e vlerësueshme nga shoqëria “S” sh.p.k. për z. Besmir Stroka; vërtetim nr. *** prot., datë 15.10.2020, për përfitim pensioni të parakohshëm nga z. H.S, së bashku me tabelat përmbledhëse bashkëlidhur; praktikën e plotë të pensionit të znj. A.S.

⁸Me shkresën nr. *** prot., datë 23.3.2021.

⁹Me shkresën nr. *** prot., datë 19.4.2021.

Komisioni kreu një analizë financiare bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, lidhur me mundësitë financiare të familjarëve të subjektit që nga viti 2003 e në vijim, për të blerë automjetin në shtator të vitit 2014.

Në tabelën si vijuese paraqitet analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe pasurive të familjes për periudhën 2003 – shtator 2014:

Përshkrimi	2003 - shtator 2014
Të ardhura	14 264 681
Të ardhura të babait nga fitimet <i>neto</i> të shoqërisë “P-G” sh.p.k.	3 657 000
Të ardhura të babait nga fitimet <i>neto</i> të shoqërisë “S” sh.p.k.	614 130
Të ardhura të babait nga pagat dhe pensioni i parakohshëm	5 100 032
Të ardhura të motrës nga pagat pranë shoqërisë “S” sh.p.k.	469 156
Të ardhurat nga paga të nënës	4 424 363
Shpenzime	6 147 954
Pasuri	6 177 314
Automjet i blerë në vitin 2005	200 000
Automjet tip “Mercedes-Benz”	1 961 540
Likuiditetet bankare të familjarëve dhe subjektit në shtator të vitit 2014	4 015 774
Rezultati	1 939 413

Nga analiza sa më sipër, duket se familja e subjektit ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për të blerë automjetin në shtator të vitit 2014.

Konstatime të Komisionit

Subjekti ka deklaruar saktë pasurinë automjet, si dhe burimin e krijimit të saj. Deklarimet e subjektit në deklaratën *Vetting* përputhet me DPV-në e vitit 2014.

Pasuria është përfituar nga subjekti para fillimit të detyrës si gjyqtar.

Familja e subjektit ka pasur mundësi financiare për të blerë me burime të ligjshme automjetin tip “D. C” në shtator të vitit 2014.

Përfundimisht, u konkludua se subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar saktë dhe me vërtetësi pasurinë automjet, ka shpjeguar bindshëm burimet e ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

2. Depozitë bankare në “Intesa Sanpaolo Bank”, në lekë

Gjendje në shumën 1.503.296 lekë, në periudhën 1.1.2015 - 30.12.2016.

Vlera e deklaruar: 1.503.296 lekë

Zotërimi: 100%

Burimi i krijimit: dhuratë nga familja.

Në DPV-në e vitit 2015 subjekti ka deklaruar shumën 1.500.000 lekë.

Në DPV-në e vitit 2016 është deklaruar shtesa nga interesat në vlerën 3.296 lekë.

2.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

“Intesa Sanpaolo Bank”¹⁰ ka konfirmuar gjendjen e llogarisë së subjektit Besmir Stroka. Referuar pasqyrave të llogarive të dërguara nga banka për subjektin e rivlerësimit ka rezultuar gjendje shuma 1.500.000 lekë në llogarinë e depozitës, si dhe shtesa në shumën 3.296 lekë në llogarinë rrjedhëse deri më 30.12.2016.

Gjendja në llogaritë e subjektit në periudhën 2014 – 30.12.2016 rezulton e njëjtë me atë të deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

2.2 Burimi i krijimit

Subjekti është pyetur nga Komisioni në lidhje me burimin e krijimit të kësaj depozite bankare të deklaruar prej tij, si dhuratë nga prindërit dhe ka shpjeguar¹¹ se: “... *depozita bankare është krijuar përpara fillimit të detyrës si gjyqtar, të cilat kanë qenë kursime të përbashkëta në vite të familjes. Arsyeja se përse kjo shumë është depozituar në llogari, ka qenë për shkak të aplikimit për vizë pranë ambasadës italiane dhe këto të ardhura do të shërbenin si garanci*”.

Subjekti ka deklaruar në pyetësorin standard se deri në vitin 2019 ka banuar me prindërit dhe motrën dhe se këto pasuri janë krijuar nga kursimet e përbashkëta të familjes. Nga hetimi i kryer referuar certifikatës familjare¹² subjekti paraqitet i vetëm, me status beqar, pasi ka kryer veçimin familjar më 21.11.2014, me aktin nr. ***.

Në lidhje me dhuratat e deklaruara nga familja Komisioni i ka kërkuar subjektit të dokumentojë investimet e kryera nga prindërit mbi pasuri të luajtshme apo paluajtshme deri në momentin e dhënies së dhuratave, me qëllim evidentimin sa më të saktë të mundësive financiare të prindërve të subjektit.

Subjekti¹³ ka depozituar dokumentacion provues mbi investimet e kryera nga prindërit e tij deri në momentin e dhënies së dhuratave, si vijon:

- i. “ndërtesë” me sip. 26.32 m² mbi truallin me sip. 100 m², rrethuar me portë më vete, me konstruksion blloqe betoni dhe me soletë, në rrugën “J. M”, Tiranë, i blerë më 16.11.1994¹⁴, në shumën 300.000 lekë. Shitësi i kësaj pasurie ka fituar pronësinë me vërtetim fakti në bazë të vendimit gjyqësor nr. ***, datë 31.10.1994, të Gjykatës së Rrethit Tiranë¹⁵;
- ii. apartament me sip. 59 m² në rrugën “S.Ç”, Tiranë¹⁶, i cili është përfituar përmes procesit të privatizimit në vitin 1994¹⁷ nga ish-ndërmarrja Komunale e Banesave, si dhe “shtesë ndërtimore” me sip. 64 m², të kryer në vitet 1997-1998, për të cilën subjekti ka shpjeguar se: “*Për nevoja të banimit të gjitha familjet në pallatin ku banojnë prindërit, kanë ndërtuar secili me shpenzimet e tij shtesë ndërtimi për qëllime banimi ngjitur me pallatin ekzistues, si pjesë përbërëse e tij... Kostot për ndërtimin e kësaj shtese (sip. 64*

¹⁰Me shkresën nr. *** prot., datë 6.4.2021.

¹¹Në përgjigje të pyetësorit të datës 10.5.2021, ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 14.5.2021.

¹²Certifikatë familjare me nr. ***, lëshuar më 19.5.2021, nga Njësia Administrative Nr. *, Tiranë, e depozituar nga subjekti me e-mailin e datës 21.5.2021.

¹³Në përgjigje të pyetësorit datë 20.5.2021, mbërritur me e-mailin datë 21.5.2021.

¹⁴Me kontratë shitjeje nr. ***, datë 16.11.1994.

¹⁵Në datën 14.5.2021, në përgjigje të pyetësorëve datë 10.5.2021 dhe 12.5.2021, subjekti ka depozituar dokumentacionin e pronës nr. ***-ND, vetëdeklarimin për legalizimin e ndërtimit datë 15.11.2006, lejen e legalizimit nr.***, datë 31.10.2019.

¹⁶Për shkak të ndryshimit të sistemit të adresave, rruga “S. Ç” është e njëjta adresë me bulevardin “Zhan D’ark” Tiranë.

¹⁷Në datën 21.5.2021, subjekti ka dërguar dokumentacionin: kontratën e shitblerjes datë 4.3.1994; certifikatën e pronësisë për pasurinë nr. *** (apartament me sip. 59 m²) dhe kartelën e pasurisë.

m²) kanë qenë minimale duke blerë vetëm materialet e ndërtimit, pasi si krahë pune për ndërtimin e saj kanë shërbyer prindërit, të afërm, xhaxhai dhe një shok i babait¹⁸”;

- iii. automjet tip “Mercedes-Benz”, viti i prodhimit 1985, blerë nga babai, z. H. S, në vitin 2005¹⁹, në vlerën 200.000 lekë.

Nga verifikimi ka rezultuar se dokumentacioni i automjetit i dërguar nga subjekti përputhet me aktet e administruara nga DPSHTRR-ja²⁰.

Nga hetimi i Komisionit nuk u evidentuan investime të tjera në pasuri të luajtshme apo të paluajtshme.

Komisioni kreu analizën financiare të familjarëve të subjektit nga viti 2003 deri në momentin e dhënies së dhuratave, me qëllim evidentimin sa më të saktë të mundësive financiare të prindërve të subjektit.

2.3 Analiza financiare

Nga verifikimi i llogarive bankare të subjektit ka rezultuar se subjekti Besmir Stroka ka pasur depozitë bankare duke filluar nga viti 2007, në BKT. Në vitet më pas kanë rezultuar depozita të hapura në “Intesa Sanpaolo Bank” dhe “Raiffeisen Bank”. Në tabelën vijuese janë pasqyruar gjendjet në fund të çdo viti, nga viti 2007 për depozitat në emër të subjektit, nga ku duket se në vitin 2010 në emër të z. Besmir Stroka është çelur një depozitë në shumën 1.500.000 lekë në “Raiffeisen Bank” me përshkrimin “depozituar nga bankë tjetër”.

Pasqyrë e depozitave ndër vite në emër të subjektit Besmir Stroka

Viti	Depozitë BKT, në lekë	Depozitë “Raiffeisen Bank” në lekë	Depozitë në “Intesa Sanpaolo Bank”, në lekë	Total
2007	100 000			100 000
2008		100 000		100 000
2009				-
2010		1 500 000		1 500 000
2011		1 500 000		1 500 000
2012		2 000 000		2 000 000
2013		-	2 000 000	2 000 000
2014		1 000 000	1 500 000	2 500 000
2015		1 000 363	1 500 000	2 500 363
2016		1 000 448	1 501 235	2 501 683

Komisioni verifikoi llogaritë e babait të subjektit, nga ku ka rezultuar se ky i fundit ka pasur një numër të konsiderueshëm të depozitave bankare ndër vite, siç pasqyrohet edhe në tabelën vijuese.

Sa më sipër, janë evidentuar disa lëvizje bankare nga llogaria e babait, përpara vitit 2010, si vijon:

¹⁸Për ndërtimin informal subjekti ka depozituar formularin e vetëdeklarimit për legalizimin e shtesës ndërtimore në emër të z. H.S, i përfunduar në vitin 1998, si dhe pamje fotografike të shtesës ndërtimore.

¹⁹Me kontratën e shitjes së automjetit nr. ***, datë 24.8.2005.

²⁰Me shkresën nr. *** prot., datë 19.3.2021.

- në datën 4.12.2008 është tërhequr *cash* shuma nga një depozitë prej 500.000 lekësh, në “Tirana Bank”, depozitë e çelur në mars të vitit 2008;
- në datën 9.12.2008 është mbyllur një depozitë e dytë në “Tirana Bank”, në shumën 700.000 lekë dhe shuma është tërhequr *cash*, depozitë e çelur në qershor të vitit 2008;
- në janar të vitit 2010, z. H.S ka depozituar shumën 3.000.000 lekë, ku 2.000.000 lekë i ka mbyllur në një depozitë në emër të tij dhe në datën 26.4.2010 ka transferuar në llogarinë e subjektit shumën prej 300.000 lekësh dhe pjesën tjetër e ka tërhequr *cash*.

Tabelë me të dhënat e llogarive të babait të subjektit në vitet 2005 - 2016

Vitet	“Credins Bank”	ABI Bank	“Raiffeisen Bank”	“Intesa Sanpaolo Bank”	Total
2005			390 000		390 000
2006			907 000		907 000
2007			271 903	800 000	1 071 903
2008				800 000	800 000
2009				202 317	202 317
2010				2 000 000	2 000 000
2011				2 000 000	2 000 000
2012	2 000 000				2 000 000
2013				2 000 000	2 000 000
2014				2 000 000	2 000 000
2015				2 000 000	2 000 000
2016		2 001 714			2 001 714

Për të verifikuar mundësinë e familjes së subjektit të krijuar në vitin 2010, depozitën fillestare në shumën 1.500.000 lekë në “Raiffeisen Bank”, Komisioni analizoi të ardhurat, shpenzimet si dhe të gjitha likuiditetet bankare të familjarëve të subjektit.

Siç pasqyrohet në tabelën vijuese, duket se familja e subjektit ka pasur mundësi për të krijuar likuiditetet bankare në vitin 2010.

Analizë mbi mundësitë financiare të prindërve për dhuratën

Përshkrimi	2003 - 2010
Të ardhura të familjes	7 833 466
Shpenzime jetese 4 vetë	3 813 288
Likuiditete bankare	3 617 965
Shpenzim blerje automjeti në vitin 2005	200 000
Rezultati financiar	202 213

Konstatime të Komisionit

Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se deklaratimet e subjektit përputhen me dokumentacionin e ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

Nga analiza e kryer konstatohet se prindërit e subjektit justifikojnë me burime të ligjshme dhuratën për subjektin dhe likuiditetet në depozitë bankare. Përfundimisht, u konkludua se subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar saktë dhe me vërtetësi pasurinë depozitë bankare, ka shpjeguar bindshëm burimet e ligjshme për krijimin e likuiditeteve në këtë depozitë, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

3. Depozitë “Raiffeisen Bank”, në lekë

Gjendja e likuiditeteve të krijuara në periudhën 1.1.2015 - 30.12.2016, në shumën 1.000.448 lekë, llogari në emër të subjektit të rivlerësimit, i cili ka deklaruar si burim krijimi kursime²¹ nga paga si punonjës në shoqërinë “S” sh.p.k. dhe bursa nga Shkolla e Magjistraturës.

Depozita është krijuar në nëntor të vitit 2014, e cila është deklaruar nga subjekti në deklaratimet e viteve 2014, 2015 dhe 2016.

3.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

“Raiffeisen Bank”²² ka konfirmuar gjendjen e depozitës së deklaruar nga subjekti në shumën 1.000.448 lekë.

3.2 Analiza financiare

Komisioni kreu një analizë financiare për periudhën 2010 – 2014, për të verifikuar mundësinë e krijimit të kursimeve për të hapur depozitën në “Raiffeisen Bank”. Siç pasqyrohet në tabelën vijuese, duket se subjekti ka rezultuar me balancë pozitive, pra ka pasur burime të mjaftueshme për të krijuar depozitën.

Analizë financiare për periudhën 2010 – 2014

Përshkrimi	2010-2014
Të ardhura nga pagat (shoqëria “S” sh.p.k. dhe Shkolla e Magjistraturës)	2 160 129
Të ardhura nga interesat e depozitave	156 073
Të ardhura total	2 316 202
Shpenzime jetese	775 286
Depozita në “Raiffeisen Bank”	1 000 000
Rezultati financiar	540 916

Konstatime të Komisionit

Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e ardhur nga banka.

Subjekti ka disponuar burime të ligjshme për të krijuar depozitën në shumën 1.000.000 lekë. Në deklaratën *Vetting* ka deklaruar saktë dhe me vërtetësi pasurinë depozitë bankare, ka shpjeguar bindshëm burimet e ligjshme për krijimin e likuiditeteve në këtë depozitë, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

4. Llogari rrjedhëse në “Tirana Bank”, e çelur nga subjekti më 2.8.2016

²¹Në DPV-të e viteve 2014 dhe 2015 subjekti ka deklaruar si burim të krijimit të depozitës “kursime”, pa specifikuar prejardhjen e kursimeve të realizuara nga subjekti.

²²Me shkresën nr. *** prot., datë 26.3.2021.

Gjendja në vlerën 307.15 lekë, më 31.12.2016. Si burim krijimi janë deklaruar të ardhurat nga pagat e marra si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

4.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

“**Tirana Bank**”²³ ka konfirmuar llogarinë bankare në emër të subjektit Besmir Stroka në periudhën 2016 – 2019. Nga verifikimi i të dhënave të llogarisë në “Tirana Bank”, gjendja në këtë llogari përputhet me deklarinimin e subjektit. Nga analizimi i të dhënave bankare nuk u evidentua ndonjë problematikë.

5. Llogari bankare në “Raiffeisen Bank”, në euro

Llogaria është çelur nga subjekti më 28.1.2014 dhe më 10.8.2015 është tërhequr vlera prej 500 euro. Si burim krijimi subjekti ka deklaruar kursimet nga bursa si student i Shkollës së Magjistraturës.

5.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

“**Raiffeisen Bank**”²⁴ ka konfirmuar se subjekti Besmir Stroka ka llogari page me gjendje 564.166 lekë dhe llogari në euro me gjendje 3.07 euro.

Nga verifikimi ka rezultuar se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e ardhur nga banka. Nga analizimi i të dhënave bankare nuk u evidentua ndonjë problematikë.

6. Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank” në euro, e lidhur me kartë krediti

Gjendje 700 euro. Si burim krijimi është deklaruar financim nga “Raiffeisen Bank”.

6.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

“**Raiffeisen Bank**”²⁵ ka konfirmuar llogarinë e pagës me gjendje 564.166.09 lekë, llogari për tërheqje *Master Card* me gjendje 3.07 euro, si dhe llogari me gjendje 0.05 euro.

Nga verifikimi i kryer përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e ardhur nga banka.

7. Gjendje cash në shumën 820.000 lekë, jashtë sistemit bankar, për periudhën 1.1.2015 - 31.12.2016

Burimi i krijimit: kursimet nga paga si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Shkodër, mbyllja e llogarisë bankare nr. ***, me “Raiffeisen Bank”, në euro, si dhe shpërblimi si anëtar i bordit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

Deklarimi në DPV: kjo pasuri është deklaruar në DPV-në e vitit 2015 për vlerën 500.000 lekë dhe në DPV-në e vitit 2016 në vlerën 320.000 lekë, si dhe burimi i krijimit.

7.1 Analiza financiare

Komisioni kreu analizë financiare për te vlerësuar mundësinë e krijimit me burime të ligjshme të kursimeve të deklaruara në vitet 2015 dhe 2016. Siç pasqyrohet në tabelën vijuese, ka

²³Me shkresën nr. *** prot., datë 7.4.2021.

²⁴Me shkresën nr. *** prot., datë 26.3.2021.

²⁵Me shkresën nr. *** prot., datë 26.3.2021.

rezultuar se subjekti ka pasur mundësi të krijojë këto kursime. Në këtë analizë janë përfshirë edhe familjarë të subjektit për shkak se ai ka deklaruar se ka jetuar së bashku me prindërit deri në vitin 2019.

Përshkrimi	2015	2016
Pasuri	544 250	211 859
Automjet blerë më 16.9.2014		
Diferencë likuiditeti	544 250	211 859
Likuiditete në fund të vitit	5 124 827	5 336 686
Gjendje <i>cash</i>	500 000	820 000
Likuiditete në bankë	4 624 827	4 516 686
Detyrime	-	-
Pasuri neto	544 250	211 859
Të ardhura nga paga	2 921 325	3 390 770
Të ardhura subjekti	1 048 254	976 964
Të ardhura nga fitimi i “S” sh.p.k. (babai)	301 110	535 088
Të ardhura nga paga babai	592 560	592 560
Të ardhura nga paga nëna	709 000	712 500
Të ardhura nga paga motra	270 401	573 658
Dhurim nga prindërit		
Shpenzime	975 014	940 368
Shpenzime jetese	897 104	940 368
Shpenzime udhëtimi	77 910	
Rezultati financiar	1 402 061	2 238 543

Konstatime të Komisionit

Nga hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se subjekti ka deklaruar saktë burimin e krijimit dhe ka pasur mjaftueshëm burime të ligjshme për të krijuar kursimet *cash* në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

8. Gjetje të tjera nga Komisioni

8.1 Subjekti ka rezultuar abonent në një kontratë furnizimi për energji elektrike²⁶ në instancën Tiranë, në rrugën “J. M”, Tiranë, me status aktiv që nga maji i vitit 2007.

Lidhur me këtë fakt, subjektit i është kërkuar që të japë shpjegime përmes pyetësorit datë 10.5.2021.

Subjekti ka shpjeguar se²⁷: “Prindërit e mi janë pronarë të pasurisë nr. ***, vol. **, z. k. ***, të ndodhur në rrugën ‘J.M’, Tiranë. Këtë pronë babai im e ka blerë me kontratën e shitblerjes së datës 16.11.1994, nga shtetasi I. K., përkundrejt shumë prej 300.000 lekësh. Duke qenë se kontrata nuk ka qenë në formën e kërkuar nga ligji, nuk është bërë regjistrimi i pasurisë në ZVRPP në emër të babait tim. Nga babai im është aplikuar dhe është kryer procedura e legalizimit për këtë pasuri dhe në muajin tetor të vitit 2019 është aprovuar leja e legalizimit në emër të tij. Në datën 13.10.2020 kjo pronë është regjistruar në emër të babait tim pranë ZVRPP-së Tiranë”.

²⁶Referuar shkresës me nr. *** prot., datë 2.4.2021, të FSHU-së.

²⁷Përgjigjet mbi pyetësorin datë 10.5.2021, ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 14.5.2021.

Në vijim, subjekti ka shpjeguar se procedurat për lidhjen e kontratës me energji elektrike në vitin përkatës, kanë qenë formale dhe se prindërit kanë deklaruar emrin e tij, pasi nëna e tij ka qenë e punësuar në OSHEE, që nga viti 2001, ku ka punuar derisa ka dalë në pension në qershor të vitit 2019.

Faktet e rezultuara nga hetimi i Komisionit

ZVRPP-ja Tiranë²⁸ ka informuar se nuk figuron e regjistruar pasuri e paluajtshme në pronësi të subjektit Besmir Stroka.

UKT-ja²⁹ konfirmon se shtetasi H.S ka kontratë shërbimi për objektin në rrugën “J.M”, pranë IMT-së Tiranë, në kategorinë e konsumatorëve familjarë, me status aktiv dhe detyrime të likuiduara deri në muajin janar të vitit 2021, ndërsa subjekti Besmir Stroka nuk rezulton të ketë kontratë shërbimi me këtë institucion.

ASHK Drejtoria e Përgjithshme³⁰ konfirmon se shtetasi H.S rezulton i pajisur me leje legalizimi nr.***, datë 31.10.2019, për pronën e ndodhur në Tiranë.

Konstatime të Komisionit

Sa më sipër, referuar dokumentacionit të përcjellë nga subjekti³¹, si dhe nga aktet e administruara pranë Komisionit, kjo pasuri është blerë nga babai në vitin 1994, në vlerën 300.000 lekë dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti përputhen me aktet e administruara në dosje.

Subjektit iu kërkua të depozitohë foto aktuale për këtë pasuri, i cili në prapësime depozitoi disa foto të banesës, nga ku rezultoi se deklarimet e tij përputhen me pamjet e banesës, si dhe me dokumentacionin e administruar për këtë pasuri.

8.2 Në lidhje me transfertat monetare

Nga hetimi i kryer nga Komisioni referuar shkresës së AK Invest³² rezultoi se janë kryer 3 transaksione monetare në emër të subjektit, si vijojnë:

- dy transaksione, respektivisht në vlerat 500 euro në datën 17.12.2014 dhe 451 euro në datën 25.12.2014, me dërgues A. P dhe përfitues Besmir Stroka;
- një transaksion në vlerën 999.99 euro, në datën 15.3.2015, me dërgues shtetasi Besmir Stroka dhe përfitues shtetasi A. P.

Subjekti është pyetur nga Komisioni³³ lidhur me marrëdhënien me shtetasin A.P, i cili ka shpjeguar se³⁴: “Shtetasin A. P e kam djalë teze...³⁵”.

²⁸Me shkresën nr. *** prot., datë 22.1.2018, ZQRPP-ja informon ILDKPKI-në mbi shkresën e ZVRPP-së Tiranë me nr. *** prot., datë 13.2.2018.

²⁹Me shkresën nr. K-*** prot., datë 30.3.2021.

³⁰Me shkresën nr. *** prot., datë 30.3.2021.

³¹Subjekti ka depozituar si dokumentacion justifikues: kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 16.11.1994, së bashku me hartën treguese dhe aktmarrëveshjen bashkëlidhur; vërtetim hipotekor nr.***, datë 23.11.1994, së bashku me hartën treguese bashkëlidhur; leje legalizimi nr.***, datë 31.10.2019, në emër të z. H.S, së bashku me formularin e vetëdeklarimit në emër të z. H. S, datë 15.11.2006, dhe praktikën bashkëlidhur; certifikatë për vërtetim pronësie datë 30.6.2017 së bashku me hartën treguese dhe kartelën bashkëlidhur; libreza e furnizimit me ujë të pijshëm lidhur midis z. H.S dhe UKT- sh.a. për pasurinë e sipërcituar.

³²Me shkresën nr.*** prot., datë 24.3.2021.

³³Me e-mailin e datës 12.5.2021.

³⁴Në përgjigje të pyetjes shtesë, mbërritur me nr. *** prot., datë 14.5.2021.

³⁵Subjekti ka dërguar dokumentacionin: certifikatë personale të shtetasit A.P; certifikatë familjare të shtetasit A.P; certifikatë e trungut familjar e shtetasit I.P; deklaratë noteriale me nr. *** rep., datë 14.5.2021, nga shtetasi A.P; deklaratë noteriale me nr. ***, datë 14.5.2021, nga shtetasja I.P.

Konstatime të Komisionit

Subjekti dha shpjegime të qarta, të shoqëruara me dokumentacion provues, lidhur me transaksionet monetare të kryera. Shpjegimet e subjektit ishin bindëse dhe u vlerësuan si të tilla ne vlerësimin përfundimtar.

8.3 Lidhur me banesat në përdorim – subjekti ka deklaruar në pyetësonin standard se nuk ka përdorur pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi të personave të tjerë.

Në deklaratën *Vetting* dhe në DPV-të në vite ka deklaruar të njëjtën adresë banimi: lagja nr. *, rruga “S.Ç”, p. *, shk. *, ap. **, Njësia Administrative Nr. *, Tiranë, e cila përputhet me adresën e regjistruar në gjendjen civile³⁶.

Konstatime të Komisionit

Zyra e Gjendjes Civile ka konfirmuar adresën e banimit të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

8.4 Të dhëna nga sistemi TIMS³⁷, nga verifikimi përputhen me deklaratimet e subjektit lidhur me udhëtimet e kryera dhe personat që e kanë shoqëruar në udhëtim.

Analiza financiare përmblendhëse për periudhën 2014 - 2016

Përshkrimi	2014	2015	2016
Pasuri	2 526 343	544 250	211 859
Automjet blerë më 16.9.2014	1 961 540		
Diferencë likuiditeti	564 803	544 250	211 859
Likuiditete në fund të vitit	4 580 577	5 124 827	5 336 686
Gjendje <i>cash</i>		500 000	820 000
Likuiditete në bankë	4 580 577	4 624 827	4 516 686
Detyrime	-	-	-
Pasuri neto	2 526 343	544 250	211 859
Të ardhura nga paga	4 383 082	2 921 325	3 390 770
Të ardhura subjekti	859 188	1 048 254	976 964
Të ardhura nga fitimi i shoqërisë “S” sh.p.k. (babai)	23 810	301 110	535 088
Të ardhura nga paga babai	592 560	592 560	592 560
Të ardhura nga paga nëna	711 552	709 000	712 500
Të ardhura nga paga motra	234 432	270 401	573 658
Dhurim nga prindërit	1 961 540		
Shpenzime	879 992	975 014	940 368
Shpenzime jetese	879 992	897 104	940 368
Shpenzime udhëtimi		77 910	
Rezultati financiar	976 747	1 402 061	2 238 543

Nga analiza financiare e kryer për periudhën 2014 – 2016 ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë pasur burime të ligjshme për të krijuar pasuritë dhe për të përballuar shpenzimet ndër vite.

Konkluzion përfundimtar mbi pasurinë

³⁶Me shkresën nr. *** prot., datë 29.3.2021, të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

³⁷Me shkresën nr. *** prot., datë 25.3.2021, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit vërehet se subjekti ka deklaruar saktë pasurinë dhe nuk janë konstatuar elemente, që mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë prej tij dhe se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme. Pas verifikimit, deklaratimet e subjektit rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin. Subjekti ka burime të ligjshme financiare për krijimin e tyre.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim identifikimin nëse ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 ka dërguar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaratimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjta gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, DSIK-ja ka dërguar një raport³⁸ në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, me konstatimin mbi përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit Besmir Stroka (i deklasifikuar me vendimin nr. ***, datë 26.5.2021, të KDZH-së).

Konstatime të Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në analizimin e:

- raportit³⁹ të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit;
- kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij);
- denoncimeve të paraqitura sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- i) formularit të vetëdeklarimit të tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit Besmir Stroka, si dhe të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë këtë formular dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit;
- ii) pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;

³⁸Raporti i DSIK-së, deklasifikuar me vendimin nr. ***, datë 26.5.2021, të KDZH-së.

³⁹Raporti me nr. *** prot., datë 27.4.2021, i KLGJ-së.

iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit

a) Saktësia e formularit të vetëdeklarimit

Formulari i vetëdeklarimit nuk është i plotësuar nga subjekti i rivlerësimit në rubrikën C “të dhëna për vetëvlerësimin profesional”, në pikën 3 dhe 4 të kësaj rubrike. Pjesët e tjera paraqiten të plota dhe sipas shtojcës që përcakton ligji. Nuk ka kundërthënie, nuk ka mangësi dhe është i nënshkruar rregullisht. Ai ka deklaruar si periudhë të rivlerësimit 3 vitet kalendarike, 2014 – 2016.

b) Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit

Sipas të dhënave të deklaruara në formularin e vetëvlerësimit, subjekti i rivlerësimit, nga periudha tetor 2014 – qershor 2016, ka qenë gjyqtar stazhier në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nga qershori i vitit 2016 deri aktualisht, ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

c) Detyrat e kryera 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore

Gjyqtari Besmir Stroka, në 3 vitet e fundit, ka kryer stazhin profesional si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, detyrë të cilën e ka kryer deri më 22.6.2016. Në datën 23.6.2016 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, detyrë të cilën e vazhdon edhe aktualisht. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër ushtron detyrën e gjyqtarit në dhomën civile, ndërsa si gjyqtar stazhier në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në dhomën civile e penale dhe gjatë hetimeve paraprake. Nuk ka specializim në ndonjë fushë të së drejtës.

Lidhur me ngarkesën sasiore të subjektit të rivlerësimit, sipas tabelave statistikore të paraqitura, rezulton se në periudhën 2014 – 2015 i janë caktuar gjithsej 150 çështje gjyqësore (civile, penale themeli dhe masa sigurimi) dhe ka deklaruar se ka përfunduar 144 çështje gjyqësore (civile, penale themeli dhe masa sigurimi). Për periudhën 1.9.2015 – 23.6.2016 nuk ka pasur çështje pranë kësaj gjykate. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër në intervalin kohor 14.7.2016 - 8.10.2016 i janë caktuar 111 çështje dhe ka përfunduar 82 çështje.

Të dhënat statistikore i ka shoqëruar me dy tabela statistikore dhe me vërtetimin datë 20.1.2017, të rregullta nga pikëpamja formale (të nënshkruara nga kryesekretarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe me vulë të kësaj gjykate), si dhe tabelën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, lëshuar nga kancelari i kësaj gjykate, e rregullt nga pikëpamja formale.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË ish-KLD-SË

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale konstatohet se gjyqtari Besmir Stroka ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 13.7.2009 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2015. Fillimin në detyrë e ka me dekretin nr. 8768, datë 31.10.2014, të Presidentit të Republikës, ku është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe me dekretin nr. 9654, datë 23.6.2016, të Presidentit të Republikës është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Më pas, z. Besmir Stroka, me vendimin nr. 6, datë 21.12.2018, të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet përkohësisht në

Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, deri kur me vendimin nr. 176, datë 11.9.2019, të Këshillit të Lartë të Gjyqësor rikthehet në pozicionin e mëparshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Besmir Stroka nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e ish-KLD-së.

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Besmir Stroka, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është paraqitur asnjë kërkesë për procedim disiplinor nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë marrë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Analiza e gjetjeve

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënave nga burimet arkivore në ish-KLD.

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në aktet e vëzhguara është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Gjyqtari kualifikon drejt marrëdhënien juridiko-civile, objekt shqyrtimi gjyqësor. I kushton rëndësinë e duhur identifikimit të kërimit të palëve, dëgjon kërkimet procedurale të tyre, shprehet në çdo rast me urdhra dhe vendime të ndërmjetme të arsyetuara, tregon vëmendje për formën e provave të kërkuara nga palët. Identifikon rastet kur, për sqarimin e fakteve që kanë lidhje me mosmarrëveshjen duhen njohuri të posaçme, duke thirrur ekspertët e fushës. Në disa raste, subjekti përdor referenca në vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, jurisprudencën e GJEDNJ-së, në KEDNJ, dispozitat Kushtetuese apo ligjet specifike. Subjekti ka njohuri për parimet e përgjithshme të së drejtës dhe i përdor në procedurën e gjykimit, ndonëse në tekstin e vendimeve nuk i analizon shprehimisht ato.

Gjyqtari ka njohuri në të drejtën penale, ku kombinon mirë rregullat e pjesës së përgjithshme me ato të pjesës së posaçme të Kodit Penal. Gjithashtu, ka njohuri edhe në të drejtën procedurale penale, për rregullat e aplikimit të gjykimit të shkurtuar, si dhe vleftësimin dhe caktimin e masës së sigurimit.

Ndër pesë dosjet e vëzhguara janë ankimuar 2 vendime gjyqësore përfundimtare të dhëna prej tij. Në 1 rast gjykata e apelit ka vendosur mospranimin e ankimit, ndërsa në rastin tjetër, gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, ndërsa në 3 raste vendimi i dhënë nga gjyqtari Besmir Stroka nuk është ankimuar. Për sa i përket tri dokumenteve ligjore, nga aktet e paraqitura, rezulton se për 2 prej tyre është paraqitur ankim dhe gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi dhe miratimin e vendimeve të dhëna.

Së fundmi, përgjatë periudhës së rivlerësimit, ndaj gjyqtarit Besmir Stroka nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e ish-KLD-së. Gjithashtu, sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Besmir Stroka përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është paraqitur asnjë kërkesë për procedim disiplinor nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë marrë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Besmir Stroka ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare plotësojnë elementet e përcaktuara nga ligji, janë të ndarë në tri pjesë dhe janë të qartë e të kuptueshëm. Subjekti respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standardizuar sipas një metodologjie të caktuar. Kjo metodë strukturimi është ndjekur pothuajse në të gjitha aktet e vëzhguara.

Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore dhe e plotësuar sipas rastit me pjesë edhe nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë, referenca në jurisprudencën e GJEDNJ-së. Dispozitivi i vendimit është i plotë dhe i qartë, kur është rasti shoqërohet edhe me urdhërezekutimin, i cili nuk tregon zyrën e përmbartimit shtetëror ose privat, si subjekti që ngarkohet për ekzekutimin e detyrueshëm të këtij vendimi, por tregon faktin që urdhërezekutimi lëshohet vetëm në një kopje.

Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar asnjë rast nga tri dokumentet ligjore dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, që të jetë cenuar nga Gjykata e Apelit ose Gjykata e Lartë, për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në dispozitivin e vendimit, në rastet e vëzhguara, është konstatuar se disponohet për shpenzimet gjyqësore, si dhe tregohet e drejta e ankimit për palët, sipas rastit edhe për palët në mungesë. Subjekti i kushton rëndësi arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, ku pasqyrohet shkaku dhe baza ligjore.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit Besmir Stroka, në 3 vitet e fundit ka kryer stazhin profesional si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, detyrë të cilën e ka kryer deri më 22.6.2016. Në datën 23.6.2016 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, detyrë të cilën e vazhdon edhe aktualisht. Në rubrikën e të dhënave statistikore, si gjyqtar stazhier në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, subjektit të rivlerësimit, sipas tabelave statistikore të paraqitura në periudhën 2014 – 2015, i janë caktuar gjithsej 150 çështje gjyqësore (civile, penale themeli dhe masa sigurimi), si dhe ka deklaruar se ka përfunduar 144 çështje gjyqësore (civile, penale themeli dhe masa sigurimi). Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 96%.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën tetor 2014 - shtator 2015, për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se gjyqtari Besmir Stroka ka gjykuar gjithsej 161 çështje gjyqësore, nga të cilat 141 çështje civile (17 civile të përgjithshme, 4 familjare dhe 120 kërkesa civile), si dhe 20 çështje penale (3 penale themeli dhe 17 masa sigurimi). Për periudhën 1.9.2015 – 23.6.2016, sipas vërtetimit të paraqitur, subjekti nuk ka pasur çështje për gjykim pranë kësaj gjykate.

Sipas germës “g”, të pikës 3, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, që nuk është organizuar në seksione, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në 1 vit, në jo më pak se 200 gjykime çështjesh penale (krime e kundërvajtje) dhe çështje civile me palë kundërshtarë. Sipas të dhënave statistikore rezulton se ngarkesa e gjyqtarit Besmir Stroka me 24 çështje të tilla ka qenë nën standardin minimal.

Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short për gjyqtarin Besmir Stroka, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve ka qenë në intervale kohore nga 1 ditë deri në 2 muaj e 7 ditë. Çështja që ka pasur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit 2 muaj e 7 ditë ka qenë çështje civile dhe në përfundim të gjykimit është disponuar me vendim rrëzimi i kërkesës. Në tri dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 29 ditë, 19 ditë dhe 1 muaj e 2 ditë.

Në 1 nga 3 dosjet civile nuk është respektuar afati standard i gjykimit, ku afati është tejkaluar me 7 ditë, nga afati standard 2-mujor. Shkak për tejkalimin e afatit standard për këtë dosje ka qenë sjellja e palës kërkuese në proces, si dhe mungesa e gjyqtarit për shkaqe objektive (qenia në gjykime penale). Ndërsa çështja që është gjykuar për 1 ditë ka qenë çështje administrative penale “vleftësim e caktim mase sigurimi”.

Për sa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve në tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për dokumentin 1, nuk mund të identifikohet kohëzgjatja e tyre, pasi nuk ka të dhëna se kur është regjistruar apo shortuar çështja. Për sa i përket dokumentit 2, çështja është gjykuar për 4 muaj e 21 ditë brenda afatit 6-mujor, të përcaktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit dhe dokumenti 3 është gjykuar për 1 ditë, bazuar në nenin 259/5 të Kodit të Procedurës Penale. Kohëzgjatja e gjykimit nga subjekti i rivlerësimit ka respektuar natyrën urgjente të këtyre lloj kërkesave dhe, rrjedhimisht, ka respektuar edhe standardin e procesit të rregullt ligjor.

Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Konkretisht, arsyetimi i vendimeve për pesë dosjet e vëzhguara është kryer 3 - 12 ditë nga shpallja. Nga këto rezulton se 1 nga 5 vendimet e vëzhguara, vendimi gjyqësor penal, është arsyetuar jashtë afatit ligjor 5-ditor, duke e tejkaluar këtë afat me 7 ditë, megjithëse për këtë çështje palët kanë qenë dakord me zgjidhjen e dhënë dhe nuk kanë ushtruar ankim.

Në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti i rivlerësimit Besmir Stroka e respekton kohën në gjykim, si një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, si dhe i kushton rëndësi kohës së arsyetimit të vendimeve gjyqësore. Në këtë drejtim duhet evidentuar se koha është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Gjyqtari Besmir Stroka ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje shpejt nga brenda ditës së shortit – 4 ditë me marrjen e akteve të çështjes me short, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore, me përjashtim të dosjes 3, ku mungon vendimi për caktimin e seancës përgatitore. Nga aktet e njoftimit rezulton se edhe kjo çështje është vënë në lëvizje për 5 ditë nga shorti. Në 3 çështjet civile të vëzhguara ka kryer gjithnjë veprimet përgatitore dhe vendimi i kalimit të çështjes në seancë gjyqësore është pjesë e procesverbalit të veprimeve përgatitore. Në dosjen penale dhe atë për vleftësimin e caktimin e masës së sigurimit ka vendim për kalimin e çështjes penale në seancë gjyqësore, gjithashtu, gjenden edhe akte të njoftimit të palëve.

Ai kryen veprime përgatitore, të cilat kanë qenë efektive dhe i kanë shërbyer ecurisë së shpejtë të gjykimit. Në 5 çështjet e vëzhguara gjykimet kanë përfunduar me 1-5 seanca. Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar 16 seanca gjyqësore, nga të cilat 11 kanë qenë produktive. Pengesë në 5 seanca joproductive kanë qenë mungesa e gjyqtarit për arsye objektive (1 seancë), kërkesa për shtyrje për shkaqe të arsyeshme nga palët (3 seanca) dhe kërkesa për shtyrje e prokurorit (1 seancë).

Distanca kohore midis seancave në 3 dosjet civile të vëzhguara është e arsyeshme dhe varion nga 1 ditë distanca më e afërt deri në 19 ditë distanca më e largët. Subjekti i rivlerësimit është kujdesur për të respektuar afatin ligjor 5-ditor për përgatitjen nga palët të konkluzioneve përfundimtare me shkrim të përcaktuar nga neni 302 i Kodit të Procedurës Penale. Në çështjen penale, në caktimin e seancave gjyqësore janë respektuar afatet ligjore, si dhe janë caktuar brenda afatit 15-ditor, parashikuar nga neni 342/2 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjatë gjykimit, gjyqtari Besmir Stroka zhvillon dhe dokumenton procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet procedurale, si dhe me prezantimin e gjykatës. Orienton drejt debatin dhe hetimin gjyqësor, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve deri në dhënien e vendimit përfundimtar. Për çdo kërkesë apo hap procedural merr rregullisht mendimin e palëve në gjykim. Ai i kushton shumë rëndësi kërkimeve procedurale të palëve në funksion të garantimit të pjesëmarrjes së plotë të palëve në proces dhe të dëgjimit të pretendimeve të tyre. Disponon me vendime të ndërmjetme të arsyetuara për veprime procedurale të kryera gjatë gjykimit. Gjyqtari ka respektuar të drejtën e palëve për të siguruar përfaqësues ligjor apo mbrojtës, kryesisht kur i pandehuri nuk ka pasur mundësi financiare për të zgjedhur mbrojtës, si dhe për të marrë ekspertë të fushës për çështje që kërkon njohuri të posaçme.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit. Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara janë inventarizuar aktet procedurale. Në dosjen e masës së sigurimit gjendet vendimi i caktimit të seancës gjyqësore dhe aktet e njoftimit të palëve.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga regjistri i ankesave nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit Besmir Stroka. Gjithashtu, sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, përgjatë periudhës së rivlerësimit, për gjyqtarin nuk është paraqitur asnjë kërkesë për procedim disiplinor nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë marrë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Edhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Besmir Stroka dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Besmir Stroka. Për gjyqtarin në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi

i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Në të tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e tjera të vëzhguara nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të mos ketë respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtari Besmir Stroka komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ai ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Në të tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Besmir Stroka për të bashkëpunuar me kolegët (ka gjykuar si gjyqtar i vetëm) dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Nga vëzhgimi i dosjeve rezulton se nuk ka pasur vonesa në fillimin e seancave gjyqësore. Gjithashtu, nuk evidentohet që të ketë pasur ndonjë dështim të seancave të planifikuara për shkak të mungesës së bashkëpunimit me administratën gjyqësore. Edhe në lidhje me arsyetimin e vendimeve rezulton se bashkëpunimi i tij me administratën gjyqësore ka qenë në nivelin e duhur.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit Besmir Stroka i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 14 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Këto të dhëna tregojnë se ka marrë pjesë në 25 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare. Lënda e trajnimeve, ku ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme kryesisht me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë.

C/1 RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KOMISIONI

Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- raportit për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLGJ-ja;
- denoncimeve të paraqitura sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016;
- kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Konstatime të Komisionit

Komisioni nuk konstatoi problematika thelbësore lidhur me vlerësimin profesional, por nga dosjet e vëzhguara, sikurse është shprehur edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor ka rezultuar:

- tejkalim i afatit prej 7 ditësh nga afati standard i gjykimit të çështjes (2-mujore) dhe ka rezultuar se shkak për këtë tejkalim ka qenë sjellja e palës kërkuese në proces, si dhe mungesa e gjyqtarit për shkaqe objektive (qenia në gjykime penale);
 - vonesë prej 7 ditësh në arsyetimin e vendimit gjyqësor penal (jashtë afatit 5-ditor) dhe për këtë vendim palët kanë qenë dakord me zgjidhjen e dhënë nga gjykata dhe nuk kanë urshtruar ankim.
- ✓ **Komisioni, pas rivlerësimit të raportit të kryer nga KLGJ-ja, nuk gjeti *indicie* apo elementë që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale.**

Denoncime nga publiku

Për subjektin e rivlerësimit Besmir Stroka janë depozituar 8 denoncime nga publiku, si vijojnë:

1. Denoncim nr. *** prot., datë 24.11.2017, depozituar nga OST-ja sh.a.

Denoncuesi ka depozituar ankim për 5 subjekte rivlerësimi, ndër të tjerë, edhe për subjektin Besmir Stroka, për dy vendime gjyqësore të dhëna nga ky subjekt, me palë paditëse G.Y dhe palë e paditur OST sh.a. dhe OST sh.a., Njësia Shkodër. Denoncuesi rezulton të jetë në konflikt të vazhdueshëm me paditësin për shkak të zgjidhjes së marrëdhënies së punës pa shkaqe të justifikuar nga punëdhënësi.

Në lidhje me çështjen e parë denoncuesi pretendon se kjo gjykatë, në vendimin e saj⁴⁰, ka marrë në konsideratë një provë të paditësit (raport mjekësor), e cila nuk përmbante vulën e institucionit nga është lëshuar. Si rrjedhojë, në bazë të kësaj prove gjyqtari ka vendosur në favor të paditësit, duke vepruar në kundërshtim me ligjin.

Për sa i përket çështjes së dytë të trajtuar nga i njëjti gjyqtar, me të njëjtat palë ndërgjyqëse, denoncuesi pretendon se gjyqtari ka vendosur⁴¹ në kundërshtim flagrant me ligjin dhe provat e depozituara. Denoncuesi deklaron se paditësi është vëllai i një prej gjyqtarëve që ushtron detyrën pranë kësaj gjykate, i cili ka qenë prezent në seanca gjyqësore duke ndikuar në vendimarrjen e gjykatës.

Denoncuesi deklaron se vendimet e sipërcituara janë ekzekutuar tërësisht dhe nuk ka ndërmarrë asnjë veprim pengues për ekzekutimin e tyre.

Konstatime të Komisionit

Komisioni evidenton se denoncuesi nuk ka depozituar asnjë provë apo dokument për të vërtetuar shkelje të ligjit nga subjekti i rivlerësimit apo të dhëna se vendimarrja e subjektit të rivlerësimit ka qenë e ndikuar për shkak të ndonjë marrëdhënieje interesi apo miqësie.

- ✓ U konstatua se nuk plotësohen kërkesat e pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016.

2. Denoncim nr. *** prot., datë 25.5.2018, depozituar nga shtetasi P.K(M)

Denoncues ka depozituar ankim për 5 subjekte rivlerësimi, ndër të cilët edhe subjekti Besmir Stroka, pasi nuk është dakord me vendimarrjen e gjykatave në tërësi, të cilat e kanë zvarritur

⁴⁰Vendimi nr. ***, datë 31.7.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me objekt “detyrimin e paditësit për të paguar pagën dhe interesin për ditët e punës të hequra etj”.

⁴¹Me vendimin nr. ***, datë 5.6.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me objekt “konstatimi i pavlefshmërisë së zgjidhjes së menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës dhe detyrimi i palës së paditur t’i paguajë paditësit dëmshpërblimin e një viti page nga zgjidha e menjëhershme e kontratës së punës pa shkaqe të justifikuar ... etj.”.

procesin gjyqësor për një periudhë prej 9 vitesh, duke i mbajtur dosjet pezull qëllimisht dhe duke dhënë një vendim të padrejtë dhe në kundërshtim me ligjin.

Rezulton se denoncesi, znj. P.K(M) ka një konflikt pronësie me vellezërit e saj, të gjithë trashëgimtarë të një sipërfaqeje prone të fituar me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, ku një pjesë e konsiderueshme e kësaj prone rezultoi e përfituar nga Komisioni i Ndarjes së Tokës mbi normën e caktuar me ligj dhe, si rrjedhojë, me vendim gjyqësor të formës së prerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është vendosur shfuqizimi i pjesëshëm i AMTP-së duke kaluar në pronësi të shtetit.

Denoncuesi pretendon se ky vendim gjyqësor nuk është komunikuar në kohë pranë ZVRPP-së së Malësisë së Madhe, nga Prefektura e Qarkut Shkodër dhe, si rrjedhojë, vëllai i denoncueses, z. Ll. T(C), ka tjetërsuar të tretët një pjesë të konsiderueshme të pronës duke qenë në dijeni të plotë të vendimit gjyqësor dhe duke vepruar në kushtet e mashtrimit. Çështja gjyqësore penale, për veprën penale të mashtrimit me të pandehur z. Ll.T, rezulton të jetë shqyrtuar nga subjekti Besmir Stroka, i cili me vendimin nr. *** (***) , datë 13.2.2018, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit për veprën penale të mashtrimit të parashikuar në nenin 143/2 të Kodit Penal.

Në lidhje me pretendimet e ngritura në këtë denoncim për zvarritje të procesit gjyqësor, subjektit iu kerkua të japë shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti shpjegoi⁴² se pretendimi i ankueses nuk është i bazuar në prova, pasi çështja penale ka shkuar për gjykim pranë subjektit më 7.9.2017 dhe gjykimi i saj ka përfunduar më 13.2.2018. Gjithsej, gjykimi i çështjes ka zgjatur 5 muaj e 6 ditë, afat ky i cili është në përputhje me rregullimet e vendosura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në Aneksin 1, të “Kritereve Matëse të Veprimtarisë Gjyqësore”, ku është përcaktuar si afat orientues afati prej 9 muajsh për gjykimin e çështjeve penale të themelit.

Ndërsa për sa i përket pretendimeve të ankuesit lidhur me themelin e çështjes, subjekti ka shpejguar se ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm në përputhje me dispozitat procedurale penale dhe ato materiale.

Konstatimi i Komisionit

Subjekti dha shpjegime të qarta dhe bindëse lidhur me pretendimet për zgjatje të afateve të gjyqimit. Nga verifikimi i dosjes gjyqësore ka rezultuar se gjykimi i çështjes është kryer brenda afateve ligjore duke respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor.

3. Denoncim nr. * prot., datë 19.10.2018, depozituar nga shtetasi V.D.**

Rezulton se ky shtetas ka depozituar ankim për 3 subjekte rivlerësimi, ndërmjet të cilëve edhe për subjektin Besmir Stroka për zvarritje të procesit gjyqësor dhe shkelje procedurale, pasi është bazuar në akte procedurale, të cilat kanë qenë pjesë e një dosjeje të pushuar.

Denoncuesi ka një konflikt pronësie dhe pretendon se vendimi gjyqësor për këtë konflikt është manipuluar nga kryetari i kësaj gjykate, i cili është pronar i fshehtë i ndërtimeve të kryera në pronën objekt gjykimi. Denoncuesi nuk ka paraqitur prova mbështetëse për sa më sipër. Nga aktet e depozituara nga denoncuesi, duket se kjo çështje duhet të jetë për shqyrtim në Gjykatën

⁴²Me prapësimet datë 4.6.2021 është depozituar edhe dosja gjyqësore përkatëse, protokolluar me nr. *** prot., datë 4.6.2021.

e Apelit Shkodër, pasi rezulton të jetë ankimuar nga ZVRPP-ja Shkodër me ankimin nr. ***, datë 3.8.2018.

Në lidhje me pretendimet e ngritura në këtë denoncim për zvarritje të procesit gjyqësor, subjektit iu kërkuan shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti shpjegoi me prapësimet e depozituara në datën 4.6.2021 se pretendimet e ngritura në këtë denoncim për zvarritje të procesit gjyqësor janë të pambështetura në prova, pasi gjatë procesit gjyqësor janë marrë në konsideratë numri i të paditurve që në rastin konkret ka qenë 6, kompleksiteti i çështjes, objekti i padisë ka qenë me disa kërkime, sjellja e palëve dhe numri i lartë i çështjeve të gjykuara në atë periudhë, të cilën e ka dokumentuar me vertetimin nr. *** prot., datë 2.6.2020, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Subjekti ka shpjeguar se seancat gjyqësore janë shtyrë me qëllim njoftimin e rregullt të palëve, kryerjen e njoftimeve nëpërmjet shpalljes, kërkesave procedurale të palëve për shtyrjen e gjykimit, nevojës për kryerjen e një hetimi të plotë e të gjithanshëm, shtimin e ndërëgjyqësisë, marrjen e provave të reja të dala rishtaz dhe vetëm një seancë gjyqësore është shtyrë për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye objektive, për shkak të një seminari trajnues të zhvilluar nga Shkolla e Magjistraturës në datat 4-5 dhjetor të vitit 2017⁴³.

Konstatimi i Komisionit

Subjekti dha shpjegime të qarta dhe bindëse mbi shkaqet, të cilat kishin çuar në zgjatje të afateve të gjykimit tej afatit të caktuar, me rregullimet e vendosura nga ish-Këshilli i Lartë Gjyqësor në Aneksin 1, të “Kritereve Matëse të Veprimtarisë Gjyqësore”.

4. Denoncim nr. * prot., datë 17.9.2019, depozituar nga person anonim**

Denoncuesi që paraqitet anonim pretendon se subjekti i rivleresimit Besmir Stroka ka vendosur pushimin e çështjes penale me kërkesë të prokurorit të çështjes, duke fshehur dokumente dhe dëshmi të kryera gjatë hetimit në favor të ish-drejtorit të ALUIZN-it për legalizime të kundërligjshme, por nuk disponon fakte apo prova konkrete për pretendimet e paraqitura.

Konstatime të Komisionit

✓ U konstatua se ky denoncim nuk plotëson kërkesat e pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016.

5. Denoncim nr. * prot., datë 3.3.2020, depozituar nga shtetasi M.K.**

Ky shtetas ka depozituar denoncim për disa subjekte rivlerësimi, por nga aktet nuk konstatohet ndonjë pretendim konkret për subjektin Besmir Stroka.

Çështja konsiston në një kallëzim penal të kryer për veprën penale “falsifikim të dokumenteve”, në bazë të së cilës pretendohet fitimi i pronësisë nga palë të treta në proces gjyqësor civil. Subjekti i rivleresimit Besmir Stroka ka vendosur⁴⁴ pezullimin e gjykimit të kësaj çështjeje civile me objekt “njohje pronar” deri në përfundim të procesit penal dhe për këtë vendim nuk rezulton që denoncuesi të ketë pretendime.

Konstatime të Komisionit

⁴³Në prapësimet e tij datë 4.6.2021, subjekti ka depozituar: dosjen gjyqësore përkatëse që i përket këtij denoncimi; certifikatë me nr. ***, datë 4-5 dhjetor 2017 për pjesëmarrje në trajnim të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës; vërtetim nr. *** prot., datë 2.6.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

⁴⁴Me vendimin nr. regj. them. ***, datë 27.3.2018.

- ✓ Nga aktet e depozituara nuk konstatohet ndonjë pretendim konkret për shkelje të ligjit nga subjekti i rivlerësimit Besmir Stroka.

6. Tre denoncime të depozituara nga shtetasit S dhe B.B.

Denoncuesi ka paraqitur tre ankime⁴⁵ duke referuar të njëjtën çështje gjyqësore për 3 subjekte ndërmjet të cilëve edhe për subjektin Besmir Stroka. Denoncuesit pretendojnë se vendimet gjyqësore kanë qenë të njëanshme dhe me veprimeve korruptive.

Denoncuesit kanë humbur të drejten e pronësisë mbi një pronë me sip. 50 m² përmes një vendimi gjyqësor të formës së prerë, i cili është vënë në ekzekutim nga përmbaruese gjyqësore znj. E.M. Ndaj kësaj të fundit denoncuesi ka kryer kallëzim penal për veprën penale “shpërdorim të detyrës”, për të cilën Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me gjyqtar Besmir Stroka, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe pushimin e çështjes penale. Denoncuesi nuk është dakord me vendimmarrjet e këtyre gjykatave civile dhe penale, pasi i kanë marrë pronën në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me ligjin.

Konstatimi i Komisionit

Nga aktet e depozituara nga denoncuesi nuk konstatohet ndonjë pretendim apo shkelje konkrete e kryer nga subjekti i rivlerësimit. Referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky denoncim nuk përmban fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, nëpërmjet një artikulli të bërë publik në media *online*⁴⁶, ka marrë dëgjime në lidhje me një çështje gjyqësore të shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit në maj të vitit 2020 për shuarjen e masës së sigurisë “arrest me burg” të disa anëtarëve të një grupi kriminal të njohur në Shkodër.

Komisioni ka administruar dosjen gjyqësore përkatëse nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër⁴⁷ për nevoja të hetimit administrativ. Nga verifikimi i akteve të kësaj dosjeje dhe vendimit gjyqësor⁴⁸ rezulton se shuarja e masës së sigurisë “arrest me burg” është kryer në respektim të neneve 261 dhe 263/1 të Kodit të Procedurës Penale, pasi paraburgimi i personave në hetim e kishte humbur fuqinë për shkak të kalimit të afateve procedurale të parashikuara në ligj.

Konstatimi i Komisionit

Nga verifikimi i akteve u konstatua se vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit është gjykuar dhe lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. **, datë 15.6.2020.

Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, i dhënë nga gjyqtari Besmir Stroka, është vlerësuar i drejtë nga Gjykata e Apelit, e cila nuk ka evidentuar shkelje ligjore të kryer nga

⁴⁵(1) Denoncim nr. *** prot., datë 21.7.2020; (2) denoncim nr. *** prot., datë 24.7.2020, gabimisht i është paraqitur Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e cila ka përcjellë dokumentacionin përkatës me shkresën përcjellëse nr. *** prot., datë 24.7.2020; (3) denoncim nr. *** prot., datë 14.11.2020, e cila i është paraqitur Kolegjit të Posaçëm të Apelit, e përcjellë pranë Komisionit me shkresën nr. *** prot., datë 11.12.2020. Ky denoncim paraqitet i palxueshëm, por nga aktet e depozituara kuptohet se bëhet fjalë për të njëjtën çështje të denoncuar pranë Komisionit.

⁴⁶CAN- C.N.A.

⁴⁷Shkresat nr. *** prot., datë 27.5.2021, protokolluar me nr. ***, datë 31.5.2021 dhe nr. *** prot., datë 28.5.2021, protokolluar me nr. ***, datë 31.5.2021.

⁴⁸Vendim nr. ** (***) , datë 20.5.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

subjekti i rivlerësimit apo të ketë kryer ndonjë veprim që cenon figurën apo aftësitë e tij profesionale.

Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Nga hetimi i thellë administrativ i kryer nuk u provua asnjë *indicie* apo element që cenon figurën e gjyqtarit Besmir Stroka dhe sipas parashikimeve në nenin 44/a të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe, përfundimisht, u vlerësua për kriterin profesional “i aftë”.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Besmir Stroka, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Besmir Stroka, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtar dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më 9.6.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda ÇIFTJA
Kryesuese

Suela ZHEGU
Relatore

Alma FASKAJ
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha